





SOLUTION D sh.p.k.

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO		
 		
Oda e Infermierëve, mativë dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora med. znakih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARHIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot. Broj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data: Datum Date
604	- 3 -	01.07.2019.
PRISHTINE · PRISTINA · PRISTINA		



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

PROJEKTIT: SOLUTION D sh.p.k."

përfaqësuar nga Driton SANAJA

dhe

ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS (OIK)

përfaqësuar nga z. Naser Rustemaj

Lënda:

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) lidhet në mes të **SOLUTION D sh.p.k.** dhe **Odës së Infermierëve të Kosovës. (OIK)** bazuar në Kërkesën e kompanise Johnson & Johnson per trajnim ne avacnimin e Infermiereve - Instrumentareve në sallat operative.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i përgjithshëm i marrëveshjes është akreditimi i aktivitetit trajnues të projektit "Rëndësia dhe Metodologjia e Përdorimit të Pajisjeve të Avancuara Mjekësore në Procedurat Kirurgjikale"

Trajnimi "Rëndësia dhe Metodologjia e Përdorimit të Pajisjeve të Avancuara Mjekësore në Procedurat Kirurgjikale" në Kosovë financohet nga Johnson & Johnson dhe kompania distributive Solution D sh.p.k.

Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është që të ngritet dhe përmirësohet metodologjia e Pajisjeve të Avancuara Mjekësore në Procedurat Kirurgjikale.

Trajnimi do të kontribuojë në tri Temat e mëposhtme (objektivat specifike):

Rezultati 1: Përdorimi dhe rëndësia e pajisjeve elektrokirurgjikale sallat operative.

Rezultati 2: Suturat dhe rendesia e tyre në Procedurat kirurgjikale.

Rezultati 3: Staplerët, menagjimi i tyre dhe përvoja në procedurat kirurgjikale.

Neni 2

Obligimet e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)

1. Fasilitasi i akreditimit të profesionistëve shëndetësor të trajnuar në të tri komponentet e projektit;
2. Të bëjë akreditimin e programeve të trajnimit sipas standardeve të Odës së Infermierëve (sipas rekomandimeve të OIK-ut);
3. Të mbështesë pjesëmarrjen e profesionistëve shëndetësor relevant në trajnime të organizuara nga të tri objektivat për t'u ngritur profesionalisht dhe në fushën e menaxhimit shëndetësor;

Neni 3

Obligimet e "Projekti "Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor" (KSHQC)

1. Përgjegjëse për menaxhimin/kontrollin/financimin e përgjithshëm të projektit dhe koordinimin me akterë të tjerë institucional pjesëmarrës në projekt;
2. Koordinon zbatimin e projektit të përgjithshëm sipas Kornizës Logjike dhe dokumenteve tjera të planifikimit;
3. Harton Planin e Veprimit specifik për përfshirjen e insitucioneve shëndetësore vendore publike në projekt;
6. Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante të tri komponentet e projektit;
7. Përpilimi i udhëzuesit/fletushkave në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante rreth projektit për qasjen në shërbime shëndetësore;

Neni 4
Realizimi i projektit

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme nga muaji Qershor 2019 deri në muajin Dhjetor 2019.

Marrëveshja mund të ndryshohet /amandamentohet me pëlqimin e ndërsjellët të palëve. Të dy palët kanë të drejtë që të rinegociojnë marrëveshjen duke u bazuar në të drejtën e tyre të përcaktuar. Çdo modifikim i kësaj marrëveshje duhet bërë me nënshkrim të të dy palëve.

Neni 5
Kushtet e përgjithshme

Kjo Marrëveshje bashkëpunimit përmban 3 faqe dhe është përpiluar në 4 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese.

Neni 6
Hyrja në fuqi


Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi. Kontrata hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

PALËT

“SOLUTION D sh.p.k.”

Driton SANAJA

(Drejtor)



Data: 01.07.2019

”Oda e Infermierëve të Kosovës”



Data: 01.07.2019